



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[19.01.2021]

BASHKIMIT TE OPERATOREVE EKONOMIKË “AEK MUNELLA” & “DRINI -1”

Lezhe, Fan, Lagjja "Gjakez", ndertese me nr. pasurie 40, zona kadastrale 1717

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Kufizuar-Sherbim /Marveshje kuader) me disa operatore ekonomik(nje fitues per çdo Lot) me objekt: “Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior”, me fond limit te marveshjes kuader 2.172.497.806 (dy miliardë njëqind e shtatedhjetë e dy milion e katerqind e nentedhjetë e shtate mije e teqind e gjashtë) lekë pa perfshire vleren TVSH, e ndare ne 14 lote, financuar nga Buxheti i Shtetit per Rajonin Verior. REF-65258-07-13-2020

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti V: REF-65268-07-13-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti V: “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Rreshen (U.Fanit)- Shpal, Shpal- Q.Bene- K.Hadroj, Shpal-Ura e Repsit", me fond limit 219.866.693 (dyqind e nentembedhjetë milion e tetqind e gjashtedhjetë e gjashtë mije e gjashtëqind e nentedhjetë e tre) lekë pa tvsh , Afati kohor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates/kontratave sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor, brenda 48 muajve te neneshkrimit te Marveshjes Kuader.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve të datës 20 Korik 2020 [Nr.43]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X



Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.“ALB SHPRESA” & “MELA” & “XHAŠT”

NUIS: J72110003F / K62320011G / K12512837I

Vlera: 150.000.000 (njqind e pesedhjetë milion) Leke

2. “JUBICA”

NUIS: K26529001I

Vlera: 175.000.000 (njqind e shtatedhjetë e pese milion) leke

3. “KTHELLA”

NUIS: J69303023D

Vlera: 135.536.616 (njqind e tridhjetë e pese milion e peseqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtembedhjetë) Leke

4. “AEK MUNELLA” & “DRINI -1”

NUIS: J98926001P / J78716317H

Vlera: 197.273.824 (njqind e nentedhjetë e shtatë milion e dyqind e shtatedhjetë e tre mijë e teteqind e njezete e kater) Leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “KTHELLA”

NUIS: J69303023D

Oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Kthella rezulton anomalisht e ulet. Komisioni i Vleresimit te ofertave bazuar ne nenin 66 te VKM-se 914, date 29.12.2014 “ rregulla te prokurimit publik, pika 5 i ka kerkuar operatorit ekonomik Analize çmimi.

Operatori ekonomik Kthella ka paraqitur analizen e çmimit si me poshte:

Marrveshja kuadër 4 vjeçare të kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve me performancë, nisur edhe nga përmirësimi i cmimeve të mirëmbajtjes rutinë, ka si qëllime kryesore :

1. Rritjen e cilësisë së nivelit të shërbimit për të gjithë përdoruesit e rrugës, nëpërmjet mirëmbajtjes eficiente 24 orë në 24.
2. Zgjatjen e jetëgjatësisë së rrugëve dhe zgjatjen në kohë të kurbës së rehabilitimit të rrugëve nacionale.



3. Përmirësimin e cilësisë së mjeteve të mirëmbajtjes nëpërmjet modernizimit të tyre dhe futjen e teknologjive të reja në procesin e mirëmbajtjes.

Lidhur me argumentimet e sjella nga ana juaj, kemi komentet tona si më poshtë vijon :

1. Ju sqaroni se objekti është në gjendje shumë të mirë

Ky është qëllimi i mirëmbajtjes së kontratave me performancë që **rruga ne fund të dorëzohet në nivelet e fillimit dhe akoma më mirë** nëpërmjet plotësimit të mirëmbajtjes për të gjithë kriteret. Por gjendja aktuale e mire e segmentit nuk përjashton mundësinë që gjatë 4 viteve të pësojë dëmtime në hapjen e gropave, dëmtimit të sinjalistikës, rrëshqitjeve, dëmtimit të murëve mbajtës e pritës, bllokimit e dëmtimit të tombinove e tjerë.

Kjo është arsyeja që në parashikimin e fondit limit janë përcaktuar zëra për të cilat rruga mund të ketë nevojë gjatë 4 viteve.

2. Ju sqaroni : Stafi, makinerite dhe puntoria e Kthellës do të organizohen nga Rrësheni cka na shmang kostot e teperta nga transporti

Nuk është bindës argumentimi i juaj. Fakti që ju keni me qera përqindje të madhe të mjeteve:

- 1 Kamion
- 1 Autobitumatrice
- 1 Rrull asfaltimi
- 1 Asfaltshtruese
- 1 Frezë asfalti
- 1 autobot
- 2 eskavatorë me zinxhir
- 1 makineri vijëzimi
- 1 batipal
- 4 **borëpastruese,**

për një periudhë 4 vjecare, përkundrazi rrit kostot e analizave të punimeve.

3. Në materialin e sjellë nga ana juaj sqaroni : “ Punimet e kategorisë mirëmbajtje rutinë janë punime të paparashikueshme dhe pa referenca në manualët zyrtarë. Askush nuk mund të parashikojë :

- Sa mm shi do bjerë e cfarë pasojash do sjellë në punimet e mirëmbajtjes rutinë
- Sa cm borë do bjerë e cfarëpasojash do sjellë në punimet e mirëmbajtjes rutinë
- Sa aksidente do të ndodhin e cfarë pasojash do të sjellin në punimet e mirëmbajtjes rutinë.



Për sa më sipër nënkupton se firma do të gjykojë vetë ajo, me uljen e saj se cfarë fitimi apo risku do të marrë përsipër dhe kjo na takon neve të gjykojmë dhe duke qënë se ky objekt është rikonstruktuar së fundmi (në pjesën më të madhe e me më shumë trafik të tij) ne mendojmë se një ulje 37-38% për këto punime është e pranueshme.

Sa më sipër ju sqarojmë :

Është totalisht e gabuar koncepti juaj për mirëmbajtjen me performancë të rrugëve. Nëse do studioni me kujdes specifikimet teknike, pjese të DST-ve, do të bindeni se mirëmbajtja rutinë kërkon monitorim dhe operim 24 orë në 24, kërkon 1 punëtor për çdo 3 km, kërkon shërbim nëse bjen apo jo shi e borë, ndodhin apo jo aksidente.

Mirëmbajtja rutinë kërkon punë pa ndërprerje për pastrim drenazhesh/tombinosh, pastrim karrexhate që as një gur i vetëm të mos jetë në të, zëvendësim të sinjalistikës së dëmtuar, zëvendësim të guardreleve të demtuara, rifreskim të vijëzimit, riparime të asfaltit nëse ka demtime e tjere. Dhe të gjitha këto punime kryhen gjatë gjithë muajit, gjatë gjithë vitit, gjatë gjithë kontratës.

Mirëmbajtja me performancë e rrugëve është një shërbim që kryhet jo me fushata kur bjen shi apo borë, por gjatë gjithë ditëve të muajit.

4. Në materialin tuaj sqaroni: “ Në procedurat e ngjashme të prokurimit....ne FSHZH, fituesit janë me një ulje nga 37.47 %....dhe si shembull ju jepni 4 objekte nga të cilat 2 rehabilitim rrugësh dhe 2 rikualifikim urban.

Sqarojmë se : Pika 5.3 e Dokumentave Standarte të Tenderit,” Ofertat anomalisht të ulta” sqaron, trajtimin e rasteve të tillë.

Krahasimi juaj me objektet e mësipërm nuk ka vend, pasi ky është **një objekt shërbimi dhe jo objekt ndërtimi.**

Komisioni i Vleresimit të Ofertave e skualifikon operatorin ekonomik duke arsyetuar dhe argumentuar lidhur me argumentimin për punimet e rehabilitimit dhe periodike si më poshtë, Në materialin e sjellë nga ana juaj, argumentim për çmimet e rehabilitimit dhe periodiket, janë sjellë vetëm 4 zëra pa sjellë analizat sipas kërkesës tonë.

Nga ana juaj janë sjellë këto zëra punimesh :



1. Shtresë stabilizant t=10 cm , me çmim 269 lekë/m2

Sqarojmë se bazuar në Manualin Nr. 3 ky zë punimesh i përket analizës 3.212/b dhe jo analizës që ju cilësoni në ofertë An. 3.197 (“ prishje shtresë çakulli”).

Analiza e rregullt sipas manualit është ndërtuar me strukturën e mëposhtme dhe është në shumën **449 lekë/m2** (pa TVSH) dhe **380 lekë/më**(pa TVSH) pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim.

	Shtrese stabilizant	
3.212/b	t=10cm	m2
	Sp + p	op
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke
	Grejder	op
	Rul me vibrim	op
	Autobot	op
	Stabilizant	m3

Duke zëvendësuar materialin me cmimin e sjellë nga ana juaj, pasi për makineritë e puntorinë nuk keni dhënë argumentim, rezulton që kjo analizë del në shumën :

302 lekë/më (Pa TVSH) – pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim

357 lekë/m2 (pa TVSH) – me shpenzimet plotësuese dhe me fitim

Pra edhe zbritja e cmimit të materialit nga ana juaj, nuk e justifikon cmimin e dhene për këtë zë nga ju 269 lekë/m2, edhe pas llogaritjes me shpenzime plotësuese Zero (0) dhe me fitim zero (0).

Cmimi i ofruar nga ana juaj është i papranueshëm

2. Shtresë binderi me granil gurë kave, 6 cm me makineri me çmim 937 leke/m2

Analiza e rregullt sipas manualit është ndërtuar me strukturën e mëposhtme dhe është në shumën **1410 lekë/m2** (pa TVSH) dhe **1664 lekë/më** (pa TVSH) pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim.

	Shtrese binderi me granil	
3.222/2	gur kave,6cm,me	m2



	makineri	
	Sp + p	op
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke
	Rul me kompresor	op
	Autobitumatriçe	op
	Asfaltoshtruese	op
	Binder	ton
	Bitum	kg
	Shuma	

Duke zëvendësuar materialin me cmimin e sjellë nga ana juaj, pasi për makineritë e puntorinë nuk keni dhënë argumentim, pra duke zëvendësuar binderin me cmimin e ofruar nga ana juaj 5145 lek/ton, rezulton që kjo analizë del në shumën :

867 lekë/më (Pa TVSH) – pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim

1023 lekë/m2 (pa TVSH) – me shpenzimet plotësuese dhe me fitim

Pra edhe zbritja e cmimit të materialit nga ana juaj, nuk e justifikon cmimin e dhënë për këtë zë nga ju 937 lekë/m2, vetëm me llogaritje një përqindje shpenzime plotësuese dhe llogaritjes me fitim zero (0).

Cmimi i ofruar nga ana juaj është i papranueshëm.

3.Shtresë asfaltobetoni me granil gurë kave , 4 cm, me makineri me cmim 805 leke/m2.

Analiza e rregullt sipas manualit është ndërtuar me strukturën e mëposhtme dhe është në shumën **1184 lekë/m2 (pa TVSH)** dhe **1397 lekë/m2 (pa TVSH)** pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim.

3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2
	Sp + p	op
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke
	Rul me kompresor	op



	Autobitumatriçe	op
	Asfaltoshtruese	op
	Asfaltobeton	ton
	Bitum	kg

Duke zëvendësuar materialin me cmimin e sjellë nga ana juaj, pasi për makineritë e puntorinë nuk keni dhënë argumentim, pra duke zëvendësuar binderin me cmimin e ofruar nga ana juaj 6462 lek/ton, rezulton që kjo analizë del në shumën :

744 lekë/më (Pa TVSH) – pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim

878 lekë/m2 (pa TVSH) – me shpenzimet plotësuese dhe me fitim

Pra edhe zbritja e cmimit të materialit nga ana juaj, nuk e justifikon cmimin e dhënë për këtë zë nga ju 805 lekë/m2, vetëm me llogaritje shpenzime plotësuese dhe llogaritjes me fitim zero (0).

Cmimi i ofruar nga ana juaj është i papranueshëm.

4.Guardrail H1 anësore, me 2 valë në një anë , W +aksesorë rruge me cmim 3710 leke/ml

Analiza e rregullt sipas manualit është ndërtuar me strukturën e mëposhtme dhe është në shumën **5245 lekë/m2 (pa TVSH)** dhe **6189 lekë/m2 (pa TVSH)** pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim.

An4	F.V guardrail- H1 anësore me 2 valz.e ne 1 ane , E3	ml
	Sp + p	op
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke
	Makineri per montim	op
	Guardrail- H1 anësore me 2 valz.e ne 1 ane , E3 + aksesoret	ml

Oferta e ofruar nga RSM, paraqitur në dokumentacionin tuaj është:

“ Furnizim guardrail H1 (me ngulje) anësore me 2 valëzime në një anë , W + aksesoret (rruge)”



Analiza qe duhet bërë është “ Furnizim vendosje”.

Duke zëvendësuar materialin me cmimin e sjellë nga ana juaj, pasi për makineritë e puntorinë nuk keni dhënë argumentim, rezulton që kjo analizë del në shumën :

4322 lekë/më (Pa TVSH) – pa shpenzime plotësuese dhe pa fitim

5100 lekë/m2 (pa TVSH) – me shpenzimet plotësuese dhe me fitim

Pra edhe zbritja e cmimit të materialit nga ana juaj, nuk e justifikon cmimin e dhënë për këtë zë nga ju 3710 lekë/m2, edhe pas llogaritjes me shpenzime plotësuese Zero (0) dhe me fitim zero (0).

Cmimi i ofruar nga ana juaj është i papranueshëm

Konkluzion :

Bazuar sa me sipër si dhe në qëndrimin e mbajtur edhe nga KPP, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur analizën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe të shërbimeve , zgjidhjet teknike të ofruara si dhe ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.

Afersia me kantierin dhe zoterimi i një pike karburanti për shitjen me pakicë nga ana e operatorit ekonomik nuk përben kusht favorizues për sa kohë që operatori nuk argumenton diferencën e cmimit që do të pëfitojë nga ky “avantazh” bazuar në kostot për mbajtjen e kanterit dhe cmimet e shumices të karburanteve.

Nga analiza e ofertes nuk janë paraqitur prova shkresore në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, rritjen dhe indeksimin e pages për periudhën e kontratës, shtimin/permiresimin e mekanikës, efektet ekonomike të inflacionit etj.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se risku i një oferte anomalisht e ulët shfaqet në rrezikun për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur dhe në asnjë rast risku nuk mund të transferohet te kontraktori sikundër pretendohet nga operatori ekonomik.

Pavaresisht natyrës së vecantë të shërbimit Autoriteti Kontraktor nuk mund të pranojë një ofertë bazuar në gjykimin dhe vlerësimin subjektiv të Operatorit Ekonomik duke anashkaluar kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.



Ne keto kushte Autoriteti kontraktor vlereson se oferta e Operatorit Ekonomik KTHELLA sh.p.k. duhet te refuzohet me arsyetimin se oferta permбан risk te larte per mospermbushjen e detyrimeve kontraktore.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.“AEK MUNELLA” & “DRINI -1”

NUIS: J98926001P / J78716317H

Vlera: 197.273.824 (njqind e nentedhjete e shtate milion e dyqind e shtatedhjete e tre mije e teteqind e njezete e kater) Leke

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 223448,]*, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.10.2020

Ankesa: ka ose jo: Ankesa PO. KPP **vendimi 562/2020, date 09.12.2020. Heqje e pezullimit sipas vendimit 562/5/2021, date 14.01.2021**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Verdho

